



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 14/08/2019

Ref.: 1443/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 76-të të mbajtur më 25.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2024;
 - Arkitekturë, MSc, 120 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik
- II. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit AAB për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Arkitekturë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 180 studentë për vit akademik
 - Teknik i Radiologjisë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik
- III. Akreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Juridik Civil, LL.M, 60 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitivin I, II dhe III të këtij vendimi.


AKA ka organizuar dy vizita të ndara në Kolegjin AAB më datë 13.05.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Balint Bachman dhe Peeter Normak, dhe vizitën e dytë me datë 30.05.2019 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Oana Sarbu, Peter Parycek, Alan Brickwood, Zdravko Lacković dhe Ulrike Webersberger.

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë, programet e studimit të përmendura në dispozitivin I, II dhe III të këtij vendimi përmbushin substancialisht standardet e akreditimit të përcaktuara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar ri/akreditimin e tyre. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

2/2